


DEKLARATË POLITIKE

Qytetare e qytetarë të Prishtinës.

Zgjedhjet lokale të 22 tetorit janë një mundësi e mirë që me daljen masive për të votuar t'i jepni legjitimitet sa më të madh demokratik organeve të ardhshme qeverisëse dhe përfaqësuese të Prishtinës dhe të dëshmoni kështu edhe një herë përgjegjshmërinë tuaj të lartë qytetare. Unë shpresoj shumë që gjendja aktuale politike, absurde, e shkaktuar nga një sjellje e pashembullt obstrukcionista e partive politike s'do t'ju demotivojë për të dalur në këto zgjedhje.

Për të gjitha ato qytetare dhe ata qytetarë të Prishtinës me të drejtë vote që ndjehen të papërfaqësuar, të pakënaqur apo të shpërfillur nga arroganca dhe vetëmjaftueshmëria e partive politike votimi për një kandidat të pavarur është alternativë e cila ia vlen të merret seriozisht në konsideratë. Me këtë rast dua t'ju siguroj që unë si përfaqësues i juaji i pavarur do të jem zëri juaj autentik.

 Naim Zeqiri

Prishtinë, më 22 gusht 2017.